



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

REKTORATI

Nr. 3636 prot.

Shkodër, më 28.10.2019

URDHËR

Nr. 336 datë 28.10 2019

“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË PRANIMIT DHE SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR REDUKTIM NË MASËN 50% NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020 NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 112, ligjin nr.10296, dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar), ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), Ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, VKM-së nr.780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet të ciklit të dytë të studimeve, në IAL-të publike

Urdhëroj:

1. Fillimin e procesit të pranimit të aplikimeve për reduktim në masë 50% nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit të ciklit të dytë.
2. Afati i aplikimit është nga data 28.10.2019-18.11.2019
3. Krijimin e komisionit të pranimit dhe shqyrtimit të aplikimeve për reduktim në masë 50% nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit të ciklit të dytë” i përbërë nga
Saida Bizaku kryetare
Rovena Mesi anëtare
Suzana Rahova anëtare
4. Komisioni mbledh aplikimet e studentëve të rregullt sipas afatit të sipërcituar harton relacionin shoqërues brenda 3 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit për aplikim dhe ia kalon drejtorisë ekonomike, për verifikim përfundimtar.
5. Drejtoria ekonomike pas verifikimit harton materialet e nevojshme për miratimin përfundimtar në Bordin e Administrimit brenda 3 ditëve kalendarike.
6. Specialisti Rovena Mesi e pajisur me user-in për akses në portalin e –albania, do të gjenerojë nga sistemi on-line certifikatat familjare apo personale të çdo aplikanti, pasi ky i fundit ka dhënë pëlqimin për administrimin e të dhënave personale (certifikata).

